



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

PRODHIME DRURI GJYSMË TË GATSHME

Niveli i III, në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

C2-III-23

Tiranë 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Prodhime druri gjysmë të gatshme			Kodi C2-III-23
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor në kualifikimin profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është <i>përgatitja e individëve për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhime druri gjysmë të gatshme</i>. Zhvillimi, te individi i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin profesional në kualifikimin profesional “Përpunim Druri”, niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK,; – janë në kushte shëndetësore të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucioni përgjegjës përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të nivelit dhe Supplementin përkatës, të punonjësit të kualifikuar në këtë kualifikim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ndërmarrje të ndryshme private/shtetërore që kanë veprimtari për prodhime gjysmë të gatshme prej druri, si: lëndë të sharruar, rimeso, kompensatë, dru të shtresuar, pllakë panel, pllakë zdrukthi dhe fibre, në ndërmarrje të prodhimit të mobilieve, dyerve, ndërtim ku përdoren kryesisht prodhime gjysmë të gatshme prej druri dhe në njësi tregtimi të këtyre prodhimeve etj.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit III të KEK, (teknik/menaxher) të arsimit profesional (njëvjeçar) në kualifikimin përkatës dhe fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme ose universitare.</p>			
Data e validimit	<i>Korrik 2023</i>			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	C-II-02-11, C-II-02-17			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

Njohuri profesionale

Në përfundim të kualifikimit profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale si më poshtë:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të shpjegojë kartën teknologjike për produktin përkatës;
- Të shpjegojë elementët e skemës teknologjike për sektorët përbërës;
- Të shpjegojë shenjat konvencionale të paraqitjes dhe klasifikimit të pllakave panel(sanduiç dhe qelizore), të zdrukthit, të kompensatës dhe fibrës;
- Të përshkruajë proceseve të punës për secilin sektor;
- Të shpjegojë mënyrën e përcaktimit të radhës së punës sipas procesit teknologjik;
- Të shpjegojë mënyrën e ndarjes së detyrave për sektorin dhe proceset përkatës të sektorit;
- Të përshkruajë urdhrin e punës për secilin proces;
- Të listojë llojet e asortimenteve të lëndës së parë(druri), veçoritë e përdorimit të tyre;
- Të listojë llojet e materialit drunor në sektorin e sharrimit të drurit, prerjes plane, tornimit të drurit për rimeso, copëtimit, frezimit dhe defibrimit;
- Të listojë llojet e materialeve ndihmëse, materialet e finisimit, veçoritë dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë llojet e materialeve ngjitëse të kompensatës, drurit me shtresa, pllakës panel, të zdrukthit dhe të fibrës;
- Të listojë llojet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme sipas proceseve;
- Të listojë llojet e makinerive sipas proceseve;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e pastrimit të vendit të punës sipas standardeve me mjetet përkatëse;

Parapërgatitja për punë

- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të vendit të punës, në mënyrë ergonomike;
- Të shpjegojë mënyrën e sistemimit të materialeve para dhe pas punimit në vendin e caktuar sipas procesit teknologjik;
- Të listojë llojet e instrumenteve prerëse të nevojshëm sipas makinave përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit paraprakë të instrumenteve;
- Të shpjegojë mënyrën e vendosjes së instrumentit në makinë;
- Të shpjegojë mënyrën e zgjedhjes së transportit sipas sektorit përkatës;

Punime në depozitën e lëndës së parë

- Të përshkruajë mënyrën e marrjes në dorëzim të lëndës drunore në depozitë;
- Të shpjegojë mënyrën e matjeve të lëndës së parë dhe mjetet përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën llogaritjes së vëllimit të lëndës së parë dhe sipërfaqes së depozitës,

- sipas kushteve;
- Të shpjegojë veçoritë e ndarjes së trupave për lëndë të sharruar në grupe diametrike;
- Të shpjegojë ndryshimet, referuar karakteristikave të trupave për kompensatë nga ato për rimeso dekorative;
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimit dhe organizimit të rezervës dimërore;
- Të shpjegojë mënyrat e ruajtjes së trupave për lëndë të sharruar, rimeso dhe kompensatë;
- Të shpjegojë mënyrat e stivimit të materialit drunor në depozitë;
- Të përshkruajë rëndësinë e etiketimit të stivave me material sipas parametrave të caktuara;
- Të shpjegojë mënyrat e përcaktimit të regjimit për çdo metodë të ruajtjes së materialit drunor;
- Të shpjegojë vartësinë e parametrave të regjimit referuar karakteristikave të lëndës së parë të drurit dhe mënyrën e ndjekjes së tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e dedektimit për metale, shkurtimit të trupave të rimesos, heqjen e lëvores dhe mbeturinave të tjera;
- Të shpjegojë rëndësinë e formës dhe përmasave të ashklave në cilësinë e pllakës;
- Të shpjegojë parametrat cilësor të lëndës drusore për pllaka me dru masiv dhe pllaka panel (sanduic dh qelozore).

Përpunimi mekanik i drurit

- Të përshkruajë metodat e sharrimit dhe modelet e prerjes së trupave;
- Të përshkruajë skema kinematike për makineritë që përdoren për përpunimin mekanik të drurit në prodhime gjysmë të gatshme druri;
- Të përshkruajë proceset e punës sipas makinerisë përkatëse;
- Të përshkruajë makineritë e sharrimit të trupave, llojet, veçoritë, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e punimit në makineritë e tornimit të trupave, funksionimi, përdorimi i tyre dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e rimesos teknike, si: pozicioni i thikës, kundrathikës, shpejtësia e prerjes etj.;
- Të përshkruajë makineritë e zdrugimit të prizmave prej druri për prodhimin e rimesos dekorative, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë makineritë e skuadrimit të rimesos, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë e copëtimit, mullinjtë e bluarjes të drurit, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë makineritë e defibrimit, rafinimit të drurit, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e sharrimit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e shkurtimit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e drejtimit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e nxjerrjes në trashësi, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë frezë, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e shpimit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e thithëzimit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë makineritë e zumparimit funksionimi dhe përdorimi i tyre
- Të përshkruajë makineritë e avancuara të drurit si frezë kopjuese CNC, (makinë kontroll numerik), programimin dhe lëshimin e saj për punë dhe përdorimi;

Formimi i pllakës me bazë druri

- Të përshkruajë makineritë e tharjes së fletëve të rimesos, ndërtimi, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë e tharjes së ashklave dhe fibrave, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të listojë hapat e seleksionimit të fletëve të rimesos dekorative dhe teknike;
- Të përshkruajë makineritë e bringjitjes së rimesos dhe të arnimit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë e seleksionimit të ashklave dhe fibrave, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e seleksionimit të elementeve për mesoren e pllakës panel;
- Të përshkruajë makineritë e përzierjes së lëndës ngjitëse me kimikate ndihmëse sipas recetës, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë e lyerjes së rimesos me lëndë ngjitëse, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë e lyerjes së ashklave, fibrave drunore me lëndë ngjitëse, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e lyerjes me lëndë ngjitëse të elementeve të pllakës panel;
- Të shpjegojë mënyrat e formimit të paketës së kompensatës, me fletët e rimesos teknike;
- Të shpjegojë mënyrat e formimit të drurit të shtresuar me fletët e rimesos teknike;
- Të përshkruajë makineritë e formimit të pllakës së zdrukthit, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë makineritë e formimit të pllakës së fibrës, funksionimi dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e formimit të pllakës panel sipas mesoreve përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të densitetit të pllakës së formuar;
- Të përshkruajë veçoritë e teknologjisë së procesit të prodhimit të pllakës të fibrës së butë ose izoluese, të pllakës me dendësi mesatare (M.D.F), veçoritë e procesit të thatë dhe pa lëndë ngjitëse të pllakës së fibrës.

Procese të ngjitjes gjatë presimit

- Të përshkruajë funksionin dhe përdorimin e transportierëve për furnizimin e presës me pllaka të njoma;
- Të përshkruajë veçoritë e makinerive të presimit të kompensatës dhe të drurit të shtresuar, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë veçoritë e makinerive të presimit të pllakës së zdrukthit, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë veçoritë e makinerive të presimit të pllakës së fibrës, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë veçoritë e makinerive të presimit të pllakës panel, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të rendisë parametrat e regjimit të presimit për secilën pllakë gjysmë të gatshme si dhe faktorët që ndikojnë ;
- Të listojnë aparatet matës të parametrave të regjimit;
- Të përshkruajë mënyrën e ndjekjes dhe korigjimit të parametrave të regjimit me aparatet përkatëse;

- Të përshkruajë veçoritë e ashensorëve ngarkues dhe shkarkues të presës, funksionin dhe përdorimin e tyre;

Finisimi i pllakave

- Të shpjegojë operacionet pas presimit të pllakave;
- Të shpjegojë mënyrat e veshjes së pllakave me rimeso, melaminë etj.;
- Të shpjegojë makinat e skuadrimin, veçoritë, funksionin dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë makinat e kalibrimit dhe zumparimit, funksionin dhe përdorimin e tyre;

Magazini i prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri

- Të shpjegojë mënyrat e markëtimit të pllakave, mjete përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrën e magazinimit të pllakave duke i stivuar sipas normave;
- Të listojë llojet e materialeve dhe mjetet e nevojshme për ambalazhimin, paketimin e pllakave;
- Të përshkruajë mënyrat e ambalazhimit të paketave me pllaka gjysmë të gatshme
- Të përshkruajë mënyrat e etiketimit të ambalazheve me pllaka;
- Të shpjegojë mënyrën e magazinimit të prodhimeve të ambalazhuara sipas standardit;
- Të përshkruajë mënyrën e transportit të pllakave gjysmë të gatshme prej druri, sipas standardeve.

Kontrolli i punimeve

- Të listojë aparatet për matjen e vetive të pllakave panel, zdrukthi, fibre etj. veçoritë, funksionimin dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të cilësisë sipas kartës teknologjike;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të verifikimit të cilësisë së punimeve gjatë trajtimit të lëndës së parë sipas kërkesave në depozitë;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e makinerisë sipas skicës;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve gjatë tharjes së ashklave në pajisjet përkatëse sipas kushteve teknike;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e lyerjes së ashklave, fibrave;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e formimit të pllakave (qilimit me zdrukth dhe fibra) sipas skicës;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e ngjitjes;
- Të listojë defektet mbas presimit, mënyrën e evidentimit dhe shkaqet e tyre;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të cilësisë së punimeve në sektorin e operacioneve përfundimtare të pllakave si aklimatizim, kalibrim etj., sipas kërkesave;
- Të listojë mënyrat e thjeshta të kontrollit të parametrave të ruajtjes në sektorin e magazinimit të pllakave me bazë druri;
- Të listojë mënyrat e kontrollit të cilësisë së veshjes së pllakave.

Mirëmbajtje dhe riparime

- Të përshkruajë teknikat e identifikimit dhe riparimit të defekteve gjatë proceseve të

- ndryshme për prodhimeve gjysmë të gatshme druri;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defektet të fletëve të rimesos;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë copëtimit të drurit në ashkla;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë defibrimit të drurit në makinat përkatëse;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë përpunimit të mesoreve të pllakave panel;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë seleksionimit të ashklave dhe fibrave në pajisjet përkatëse;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë lyerjes së fletëve të kompensatës, së ashklave, fibrave drunore dhe të pllakës panel me kimikate, me makineritë përkatëse;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë formimit të qilimit, me ashkla dhe fibra në makineritë përkatëse të formimit;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë presimit të qilimit me ashkla, me fibra drunore, në makineritë presë përkatëse;
- Të listojë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë presimit të paketës së kompensatës, drurit me shtresa në makineritë presë përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrat e riparimit të defekteve gjatë përpunimit të sipërfaqes dhe brinjëve të pllakave.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të listojë llojet e dokumentacioneve të nevojshme;
- Të listojë parimet bazë të kodit të punës, legjislacionin bazë të fushës së prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri, lidhur me aktivitetin që kryen;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit e arkivimit të dokumentacioneve;
- Të shpjegojë mënyrat e llogaritjeve të materialeve dhe të grafikut të kohës së punës;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të dhënave për faturat dhe mënyra e përgatitjes së një oferte;
- Të listojë llojet e raportimeve;
- Të shpjegojë mënyrën e kontrollit të çmimeve të tregut të materialeve bazuar në standardet e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- Të listojë elementët e llogaritjes së kostos materialeve dhe çmimit të një shërbimi;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes së një oferte për punimet/shërbimin që do të kryejë;
- Të listojë mënyrat e blerjes së materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të shpjegojë elementet e llogaritjes përfundimtare për punimet/shërbimet e ofruara
- Të listojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve dhe mënyra e përgatitjes;
- Të shpjegojë teknika të marketingut;
- Të përshkruajë metodat e zhvillimit profesional dhe të karrierës;
- Të përshkruajë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin “prodhime gjysmë të gatshme druri”;
- Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panaire dhe ekspozita;
- Të listojë llojet e trajnimeve dhe kurseve teknike.
- Të përshkruajë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet

- e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje;
- Të shpjegojë mënyrat e marrjes së porosisë dhe dorëzimin e punimeve te klienti;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë për krijimin e kontakteve në biznes.
- Të listojë metodat e informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të përshkruajë mënyrën e komunikimit dhe metodat e tij;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe parimet e punës në grup;
- Të listojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të shpjegojë kodin e etikës;
- Të listojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik
- Të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunëtorëve dhe roli i tyre në veprimtarinë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë, në komunikimin me të tjerët;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare.

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punës në basenet e trajtimit hidrotermik;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punës për përgatitjen e trupave;
- Të listojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë funksionimit të gatërit, sharrave për trupa, strugane horizontale, torno, makina të copëtimit të drurit në ashkla , defibrimit, rafinimit;
- Të listojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punës në makinat e tjera të linjës teknologjike të kompensatës pllakave të zdrukthit dhe fibrës si brinjëngjitjes së rimesos, lyerje, tharje, formim qilimi, presim, trajtim termik të pllakave etj.;
- Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punës në procese përfundimtare të linjës si aklimatizim, kalibrim formatizim etj.
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në punë;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të vendit të punës dhe ruajtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat dhe materialet për mbrojtjen dhe shpëtimin ndaj zjarrit (MZSH³);
- Të përshkruajë rregullat e ndihmës së shpejtë gjatë proceseve të punës, në raste aksidentesh.
- Të listojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të manualeve të mjeteve e pajisjeve të punës;
- Të listojë mënyrat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e interpretimit të sinjalistikave në mjedisin e punës;
- Të listojë procedurat e evakuimit për raste emergjence;
- Të listojë masat dhe rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;

- Të listojë karakteristikat e mjedisit të qëndrueshëm;
- Të listojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- Të listojë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
- Të listojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të listojë pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive, funksioni dhe përdorimi i tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e protokolleve të duhura në raste pandemie.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të jetë i aftë:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të analizojë kartën teknologjike për produktin përkatës si lëndë të sharruar, pllakë zdrukthi, fibër etj. ;
- Të zbërthejë skemën teknologjike për sektorët përbërës, si në sektorin e përpunimit mekanik të drurit, e seleksionimit, e tharjes, përzierjes me kimikate etj.;
- Të skicojë paraqitjen e pllakave: panel, qelizore, zdrukthi, kompensate, fibre etj.;
- Të përcaktojë proceset e punës për secilin sektor në prodhime gjysmë të gatshme prej druri;
- Të përcaktojë radhën e punës, sipas procesit teknologjik të prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri si, pllakë fibre, zdrukthi etj.;
- Të ndajë detyrat në ekip për sektorin dhe proceset përkatës të sektorit;
- Të zbatojë urdhrin e punës për secilin proces;
- Të identifikojë llojet e lëndës së parë (druri) dhe asortimentet respektive si trupa druri, anie, listela, degë voze, mbeturina druri, pllaka të vjetra, mobilie të vjetra etj.;
- Të përzgjedhë e materialit drunor në sektorin e sharrimit të drurit, e prerjes plane dhe tornimit të drurit për rimeso, në sektorin e copëtimit dhe defibrimit të drurit;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve ndihmëse dhe finisuese, sipas proceseve të punës;
- Të sistemojë veglat, mjetet dhe pajisjet e nevojshme sipas proceseve që kryen;
- Të përdorë veglat, mjetet dhe pajisjet të nevojshme sipas proceseve të punës;
- Të përdorë makineritë sipas proceseve të punës;
- Të pastrojë vendin e punës me mjetet përkatëse të pastrimit sipas rregullave dhe standardeve.

Parapërgatitja për punë

- Të organizojë vendin e punës, në mënyrë ergonomike sipas kushteve të sigurimit teknik;
- Të sistemojë materialet në vendin e punës, para dhe pas përpunimit sipas procesit teknologjik;
- Të përzgjedhë llojet e instrumenteve të nevojshëm sipas makinerive përkatëse;
- Të kontrollojë instrumentet sipas parametrave përkatës;
- Të vendosë instrumentin në makinë duke kontrolluar kushinetat, bokullat, rripat e transmisionit etj.;
- Të përzgjedhë mënyrën e transportit sipas sektorit përkatës.

Punime në depozitën e lëndës së parë

- Të marrë në dorëzim lëndën drunore si trupa druri, mbeturina druri, dërrasa, mbeturina etj., në depozitë sipas rregullave të caktuara dhe standardit;
- Të kryejë matjet e përmasave të lëndës së parë drunore si trupa, degë voze, anie listela, mbeturina rimeso dhe kompensatë për pllakë zdrukthi dhe fibre druri me mjete përkatëse;
- Të llogarisë vëllimin e lëndës së parë dhe sipërfaqes së depozitës sipas kushteve;
- Të shënojë trupat sipas grupeve diametrike për prerje në gatra;
- Të përzgjedhë trupat për kompensatë dhe rimeso dekorative, sipas llojit dhe përmasave në standard;
- Të organizojë rezervën dimërore sipas kërkesës;
- Të kryejë stivimin e trupave sipas rregullave të caktuara si ndarja në grupe diametrike, hapësirat ndërmjet stivave etj.;
- Të vendosë, mbi çdo stivë, tabelat treguese me parametrat përkatës të lëndës së parë sipas standardit;
- Të përzgjedhë mënyrën më të përshtatshme për ruajtjen e lëndës të parë për prodhime gjysmë të gatshme nga dëmtimet;
- Të përdorë mënyrat përkatëse për ruajtjen e trupave për lëndë të sharruar, rimeso dhe kompensatë;
- Të përdorë mënyrat përkatëse për ruajtjen e materialit drunor për pllaka me bazë druri, në depozitë nga dëmtimet dhe kalbja, sipas asortimentit;
- Të kryejë trajtimin termik të trupave me metodën përkatëse duke zbatuar me kujdes parametrat e regjimit;
- Të monitorojë parametrat e regjimit dhe kushtet e punës gjatë ruajtjes së materialit drunor.
- Të mbikëqyrë punime për shkurtimin në koka të trupave;
- Të realizojë dedektimin e metaleve në trupa drunorë;
- Të mbikëqyrë punime të heqjes së lëvores dhe mbeturinave të tjera të materialit drunor;
- Të mbikëqyrë punime të shkurtimit të mbetjeve të drurit për pllaka të ndryshme zdrukthi, fibre etj., sipas përmasave të gojës ushqyese të makinave copëtuese;

Përpunimi mekanik i drurit

- Të përdorë metodat e sharrimit dhe modelet e prerjes së trupave;
- Të lexojë skema kinematike për makineritë e përpunimit mekanik të drurit, gjatë prodhimit të pllakave me bazë drurin;
- Të kryejë proceset e punës sipas makinerisë përkatëse;
- Të sharrojë trupa, prizma në makineritë gatër, sharrë shirit, disk dhe me motorsharrë, sipas modelit të prerjes;
- Të realizojë tornimin e trupave për rimeso dekorative, teknike, sipas trashësisë së kërkuar, me makineritë torno;
- Të realizojë punime me makineritë strugane për rimeso dekorative, me trashësinë e kërkuar;
- Të punojë në makineritë me disk thikëmbajtës, cilindër thikëmbajtës, mullinjtë të copëtimit dhe bluarjes së drurit;
- Të punojë në makineritë defibruese dhe rafinuere për defibrimin, rafinimin e lëndës drunore, sipas përmasave të kërkuara në standard;
- Të monitorojë punime të shkurtimit me saktësi në makineritë sharrë disk sipas modelit të

- mesores të panelit;
- Të monitorojë punime për drejtimin në faqe dhe brinjë të detalit në makineritë plan sipas kartës teknologjike;
- Të monitorojë punime në makineritë grosecë sipas skicës;
- Të punojë në makineritë frezë, të profilimit të detaleve sipas modelit të panelit;
- Të punojë në makineritë trapano, sipas proceseve të shpimit të skicës;
- Të kryejë procese të thithëzimit në makineritë tenonatriçe sipas skicës;
- Të kryejë punime zumparimi me makineritë zumparuese, sipas shkallës së pastërtisë së kërkuar;
- Të punojë pllakat apo detalet në makinën CNC (makinë kontroll numerik), sipas modelit;
- Të skuadrojë pllakat apo detalet, sipas modelit, në makineritë e avancuara;

Formimi i pllakave

- Të monitorojë punime me makineritë e tharjes së fletëve të rimesos, duke ndjekur regjimin e caktuar në funksion të parametrave përkatës;
- Të ndjekë regjimin e caktuar gjatë tharjes së ashklave dhe fibrave, me makinat përkatëse;
- Të monitorojë seleksionimin e fletëve të rimesos dekorative dhe teknike, sipas cilësisë dhe përmasave të caktuara në standard;
- Të kryejë punime me makineritë e bringjitjes së rimesos teknike sipas standardit;
- Të seleksionojë ashklat dhe fibra me makineritë përkatëse sipas përmasave të caktuara;
- Të monitorojë seleksionimin e elementeve për mesoren e pllakës panel;
- Të përgatisë lëndët ngjitëse me kimikatet shtesë sipas recetës përkatëse;
- Të monitorojë procese lyerje me lëndë ngjitëse, me makineri përkatëse të fletëve të kompensatës sipas normativës së caktuar;
- Të kryejë lyerje të ashklave dhe fibrave me makineritë e lyerjes sipas normativës përkatëse;
- Të monitorojë lyerjen me lëndë ngjitëse të elementeve të pllakës panel;
- Të monitorojë formimin e paketës së kompensatës dhe drurit me shtresa, sipas mënyrës së vendosjes së fletëve të rimesos për tipin përkatës;
- Të monitorojë punimet për formimin e pllakës (qilimit) me ashkla me makineritë e formimit;
- Të monitorojë punimet për formimin e qilimit me fibra druri me makinat e formimit sipas metodës përkatëse, duke zbatuar parametrat e caktuara;
- Të kryejë punimet për formimin e pllakës panel me mesore prej rripa druri sipas standardit;
- Të kontrollojë densitetin e pllakës së formuar, me mjetet përkatëse sipas standardit.

Procese të ngjitjes gjatë presimit

- Të monitorojë transportimin e pllakave të njoma drejt makinës së presimit, me transportierë sipas procesit teknologjik;
- Të monitorojë ngarkimin e pllakave të njoma, në katet e presës me ashensorë sipas kushteve;
- Të punojë me makineritë e presimit për ngjitjen dhe presimin e paketës së kompensatës;
- Të punojë me makineritë e presimit për të ngjitjen e drurit të shtresuar;
- Të punojë për ngjitjen dhe presimin, e pllakës së zdrukthit me makineritë e presimit;
- Të kryejë punime të ngjitjes dhe presimit, të pllakës së fibrës me makineritë e presimit;
- Të monitorojë ngjitjen dhe presimin e pllakës panel me makineritë e presimit;
- Të ndjekë regjimin e presimit, me aparatet përkatëse sipas parametrave të pllakës;

- Të korrigjojë parametrat përkatës, gjatë procesit të presimit sipas nevojës;
- Të monitorojë procese pune të shkarkimit të presës, sipas rregullave;

Finisimi i pllakave

- Të monitorojë proceset pas presimit në të nxehtë të pllakave;
- ;
- Të përmirësojë sipërfaqen e pllakës duke e veshur rimeso dekorative, letër të imprenjuar, letër dekorative melaminike, PVC⁴, akrelik etj.;
- Të kryejë skuadrimin dhe kalibrimin e pllakave mbas presimit, sipas standardit;
- Të kontrollojë vetive fizike, mekanike të pllakave me mjetet e nevojshme duke i krahasuar me standardet;

Magaznimi i pllakave me bazë druri

- Të markëtojë prodhimet gjysmë të gatshme, sipas standardit;
- Të stivojë prodhimet gjysmë të gatshme të përfunduara në magazinë, sipas normave të stivimit;
- Të ambalazhojë prodhimet gjysmë të gateshe, sipas llojit;
- Të realizojë etiketimin e ambalazheve sipas kërkesës;
- Të kryejë magazinimin e produkteve të ambalazuara sipas standardeve;
- Të transportojë ambalazhet me prodhime gjysmë të gatshme sipas standardit.

Kontrolli i punimeve

- Të kontrollojë cilësinë, sipas kartës teknologjike;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve gjatë trajtimit të lëndës së parë, sipas kërkesave në depozitë;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve në sektorin e makinerisë sipas skicës;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve gjatë tharjes së ashklave në pajisjet përkatëse sipas kushteve teknike;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve në sektorin e lyerjes me lëndë ngjites së pllakave, ashklave dhe fibrave;
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve në sektorin e formimit të pllakave (qilimit me zdrukth dhe fibra);
- Të kontrollojë cilësinë e punimeve në sektorin e ngjitjes;
- Të kontrollojë defektet mbas presimit me mjetet përkatëse;
- Të monitorojë cilësinë e punimeve në sektorin e operacioneve përfundimtare të pllakave, sipas kërkesave;
- Të monitorojë cilësinë e parametrave të ruajtjes në sektorin e magazinimit të pllakave me bazë druri;
- Të monitorojë cilësinë e veshjes së pllakës me bazë druri sipas standardit.

Mirëmbajtje dhe riparime

- Të përzgjedhë teknikat e identifikimit dhe riparimit të defekteve në gjatë proceseve të

⁴ Polivinil kloridi

- ndryshme për prodhimeve gjysmë të gatshme druri;
- Të riparojë defekte e konstatuara gjatë tornimit të trupave;
- Të kryejë riparime të thjeshta të defekteve të konstatuara gjatë copëtimit të drurit në ashkla;
- Të kryejë riparime të thjeshta të defekteve të konstatuara gjatë defibrimit të drurit në makineritë përkatëse;
- Të kryejë riparime të thjeshta të defekteve të konstatuara gjatë përpunimit të mesoreve të pllakave panel;
- Të riparojë defekte të konstatuara gjatë seleksionimit të ashklave dhe fibrave drunore në pajisjet përkatëse;
- Të riparojë defekte gjatë lyerjes me ngjitës së fletëve të rimesos, së ashklave dhe fibrave me kimikate me makineritë përkatëse;
- Të riparojë defekte të konstatuara gjatë lyerjes së faqeve të pllakës panel me lëndë ngjitëse me makinat përkatëse;
- Të riparojë defekte të konstatuara gjatë formimit të qilimit, me ashkla dhe fibra në makineritë e formimit;
- Të riparojë defekte të konstatuara gjatë presimit të qilimit me ashkla dhe fibra makineritë presë përkatëse;
- Të riparojë defekte gjatë presimit të paketës së kompensatës, drurit me shtresa në makinat presë përkatëse;
- Të kryejë përpunime të sipërfaqes, brinjëve të pllakave për riparimin e defekteve dhe përmirësimin e pamjes.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të zbatojë legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin e fushës së prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri, sipas aktivitetit të kryer;
- Të plotësojë planet ditore, javore, mujore të punës, në përputhje me detyrat dhe llojin e punimeve;
- Të dokumentojë në mënyrë të saktë punën e kryer;
- Të regjistrojë të dhënat për faturat dhe ofertat e lëshuara klientëve;
- Të kontrollojë tregun lidhur me çmimet dhe cilësinë e materialeve, pajisjeve dhe produkteve;
- Të kryejë llogaritje të kostos së materialeve dhe produkteve, në bazë të projektit të dhënë;
- Të përgatisë oferta për produktet që do të prodhohen referuar çmimeve të tregut.
- Të kryejë blerje të materialeve, mjeteve, pajisjeve sipas nevojave dhe standardit të prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- Të llogarisë saktë çmimin përfundimtar për produktet e ofruara;
- Të zbatojë teknikat e duhura të marketingut për produktet që do të prodhohen sipas rregullave;
- Të identifikojë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në specialitetin “Prodhime gjysmë të gatshme prej druri”;
- Të informojë në kohë bashkëpunëtorët për njohuritë dhe aplikimin e teknikave të reja.
- Të marrë pjesë në panairë, ekspozita, në trajnime dhe kurse teknike në fushën e prodhimit të pllakave me bazë druri;
- Të identifikojë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje;
- Të për zgjedhë mënyrat e marrjes së porosisë dhe dorëzimin e punimeve te klienti;

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përdorë Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.
- Të zbatojë procedurat e marrjes së informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të zbatojë teknikat e duhura të komunikimit etik;
- Të përdorë terminologjinë profesionale në komunikim;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;
- Të përdorë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal;
- Të zbatojë kodin e etikës;
- Të zbatojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik.

Rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimeve në basenet e trajtimit hidro-termik;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimeve për përgatitjen e trupave;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë përdorimit të gatërit, sharrave për trupa, strugane horizontale, torno, makina të copëtimit të drurit në ashkla, defibrimit, rafinimit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë punimeve në makina të tjera të linjës teknologjike të kompensatës pllakave të zdrukthit dhe fibrës si bringjitjes së rimesos, lyerje, tharje, formim qilimi, presim, trajtim termik të pllakave etj.;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes të mjedisit gjatë proceseve përfundimtare të linjës si aklimatizim, kalibrim formatizim etj.;
- Të sigurojë higjienën personale në punë;
- Të zbatojë saktë manualët përkatëse në përdorimin e mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të zbatojë Standardin Kombëtar, standardet e tjera dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti sipas procedurës;
- Të respektojë sinjalistikën në mjediset e ndërtesës sipas rregullores së brendshme;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- Të zbatojë rregulloret përkatëse gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike, sipas llojit të tyre;
- Të identifikojë dhe të raportojë sipas rastit tek personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të zbatojë rregulloret e ndarjes së mbeturinave sipas llojit;
- Të depozitojë mbetjet nga procesi i punës në përputhje me rregulloret e mjedisit;
- Të ruajë dhe magazinonjë materialet në përputhje me udhëzimet përkatëse në mënyrë që të mos rrezikojë ndotjen e mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë dhe materialet, si dhe të zbatojë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përdorë pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive;
- Të zbatojë në mënyrë rigoroze protokollet e duhura në raste pandemie.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Në përfundim të kualifikimit profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme” niveli **III në KSHK**, individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj.